

Vendim nr. 83 datë 05.12.2024

(V-83\24)



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 05.12.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 4 (J) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JAMARBËR MALLTEZI**, përfaqësuar nga avokat Klodian Skënderaj, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurorët Arben Kraja dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 116, datë 23.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-1576, datë 21.11.2023 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 05.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 22, 27, 28, 29, 36, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5/1, 5/2, 5/3, 5/4, 7, 8, 10, 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Jamarbër Malltezi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, në datën 01.12.2020 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 287 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 287/2020*) për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i parë, i Kodit Penal (*KP*), ndërsa në datën 02.10.2023 ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, krahas emrave të shtetasve S.B., F.B. dhe Xh.B., edhe emrin e kërkuarit, në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i zgjedhurve vendorë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të *KP*-së dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i *KP*-së. Objekt i kallëzimit dhe hetimit në vijim kanë qenë proceset e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesi i privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani” dhe ish-klubit shumësportesh “Partizani” në Tiranë), procesi i ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe i zhvillimit të pronës.

2. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*) me kërkesë për caktimin ndaj kërkuarit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 (*vendimi nr. 112/2023*), të marrë në dhomën e këshillimit, gjykata ka vendosur pranimin e saj me argumentin se plotësoheshin kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), pasi ekzistonin dyshime të arsyeshme të bazuara në prova për kryerjen nga kërkuari të veprave penale; nuk ekzistonin rrethana padënueshmërie ose shuarje të veprës penale; ekzistonte rreziku që kërkuari të largohej, si dhe të kryente krime të rënda ose të të njëjtit lloj me ato për të cilat po procedohej. Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e lartë të veprave penale, sanksionin me

burgim që ligji parashikon për to, formën e kryerjes së tyre (bashkëpunim i thjeshtë), pasojat e ardhura, moshën, gjendjen familjare dhe gjyqësore të kërkuesit, si dhe mungesën e rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar se “Arresti në burg” ishte masa më e përshtatshme. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është ekzekutuar në datën 21.10.2023 dhe aktet përkatëse janë depozituar në atë gjykatë nga Prokuroria e Posaçme në datën 22.10.2023.

3. Pas marrjes në pyetje të kërkuesit, në zbatim të parashikimeve të nenit 248 të KPP-së dhe dëgjimit të shpjegimeve të tij e mbrojtësve të zgjedhur, me vendimin nr. 116, datë 23.10.2023 (*vendimi nr. 116/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”.

4. Kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e mësipërme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*). Me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë, caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke e urdhëruar atë të mos largohet nga banesa dhe të mos komunikojë me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë në të njëjtën banesë me të. Gjykata e apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar siç duhet kushtet dhe kriteret në caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit. Sipas saj, ndërsa janë të pranishme dy kushtet e para të përcaktuara nga neni 228 i KPP-së, ai për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprave penale (*pika 1*) dhe ai për mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë (*pika 2*), për sa i përket kushtit të tretë (*pika 3*), të njohur si frika nga liria (*periculum libertatis*) ekziston rreziku që kërkuesi të largohet për t’iu fshehur procedimit penal (*shkronja “b”*), por jo ai për të kryer krime të rënda ose të njëjta me ato për të cilat po procedohet (*shkronja “c”*). Në vijim, po sipas saj, duke mbajtur parasysh se masa e sigurimit “Arresti në burg” vendoset kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme (*neni 230 i KPP-së*) dhe se liria e individit është e drejtë natyrale njerëzore e garantuar nga akti themeltar dhe aktet ndërkombëtare, prezumimi shkon drejt lirisë së të hetuarit, në respektim të parimit të nevojshmërisë, përshtatshmërisë, proporcionalitetit dhe gradualitetit, masa e sigurimit që duhet caktuar ndaj kërkuesit është “Arresti në shtëpi”, e cila garanton më së miri rrjedhën normale të hetimit dhe siguron praninë e të hetuarit, përveçse është në raport të drejtë me rëndësinë e fakteve dhe sanksionin që parashikon ligji për veprat penale që ai dyshohet të ketë kryer.

5. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të GJKKO-së së Apelit. Po kështu, rekurs ka ushtruar edhe Prokuroria e Posaçme. Për rekursin e ushtruar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 05.03.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tyre, duke vlerësuar se gjykatat kishin argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese për pretendimet e ngritura prej tij në rekurs në lidhje me mungesën e cilësive të

posaçme në funksion të veprës penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, si dhe mungesën e dyshimeve për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i këtij kodi. Po sipas Kolegjit Penal, gjykatat kishin arsyetuar vendimmarrjet e tyre edhe në drejtim të kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas neneve 228 dhe 229 të KPP-së dhe caktimi nga GJKKO-ja e Apelit i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” ishte bërë në respektim e zbatim të drejtë të ligjit material e procedural.

6. Në datën 26.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.07.2024. Në datën 16.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes, për të cilën në datën 17.09.2024 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin. Po në datën 17.09.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërsa në datat 16.09.2024 dhe 17.10.2024 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur respektivisht pranimin e kërkesës së një gjyqtareje kushtetuese për heqjen dore nga gjykimi i çështjes, si dhe rrëzimin e kërkesës për dorëheqje të një gjyqtareje tjetër e të kërkesës së kërkuesit për përjashtimin e kësaj të fundit nga shqyrtimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për liri personale*, e garantuar nga nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi ai nuk është subjekt i veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”. Kështu, ai nuk ka ushtruar ndonjëherë funksione publike, nuk ka pasur ndonjëherë akses në dokumentacionin publik objekt hetimi, si dhe nuk mund të ndikonte në ndryshimin e tyre, për shkak të formës së nxjerrjes së tyre si akte ligjore ose nënligjore të publikuara në Fletore Zyrtare. Duke mos pasur atributet e subjektit të posaçëm, zbatimi ndaj tij i nenit 260 të KP-së është kryer në kushtet e nënshtrimit politik. Po kështu, fitimi i marrë prej tij si ortak i shoqërisë tregtare “Homeplan” sh.p.k. përbën të ardhura të ligjshme dhe në lidhje me të ka paguar të gjitha detyrimet tatimore. Për rrjedhojë, veprimet e kryera nuk përbëjnë as veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”. Prokuroria e Posaçme ka kapërcyer tagrat e saj

ligjore, duke hetuar një marrëdhënie juridiko-civile, për të cilën asnjë nga palët e përfshira nuk ka ngritur pretendime. Argumentet e kësaj prokurorie tregojnë për qasje politike, si dhe qëndrime antikushtetuese ndaj shtresës së pronarëve dhe sipërmarrjes së lirë.

7.1.2. Mungesës së *dyshimeve të arsyeshme* për kryerjen e veprave penale, pasi ndryshimet në legjislacion në kohën e qeverisjes së babait të bashkëshortes së tij, shtetasit S.B., nuk kanë pasur asnjë ndikim në privatizimin e terreneve sportive. Ky privatizim është bërë për shkak të humbjes së funksionit të objekteve si klube sportive, si rrjedhojë e zënies së tyre forcërisht nga familje ose tregtarë. Prokuroria e Posaçme nuk ka pretenduar në asnjë moment se aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara binin në kundërshtim me Kushtetutën ose ligje të tjera. Po kështu, të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve të ndërtuara dhe shpërndarja e dividendëve të shoqërisë kanë qenë rrjedhojë e aktivitetit të ligjshëm tregtar, i cili i është nënshtruar edhe kontrollit të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila nuk ka konstatuar shkelje. Pretendimet se e shoqja, subjekt i deklarimit të pasurisë, nuk ka deklaruar aktivitetin e shoqërisë janë të pabazuara, pasi ligji për parandalimin e konfliktit të interesit shtrihet te personat e lidhur me zyrtarin dhe jo tek ata që kanë lidhje me personat e lidhur. Për më tepër, neni 77 i Kodit të Familjes përcakton se të ardhurat e përfituara nga trashëgimia janë pasuri e bashkëshortit dhe nuk bëjnë pjesë në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore familjare.

7.1.3. *Parimit të proporcionalitetit*, për shkak se masa e sigurimit “Arresti në burg” ka qenë ekstreme dhe e papërshtatshme me nevojën e sigurimit, pasi nuk ekzistonte rreziku që të arratisesh, të pengonte mbarëvajtjen e drejtësisë ose të kryente krime të tjera. Ai është i martuar, me katër fëmijë, ka gradë shkencore, nuk ka qenë i dënuar më parë dhe është sipërmarrës. Po kështu, hetimet ndaj tij kanë zgjatur rreth tre vjet dhe në asnjë moment nuk ka penguar mbarëvajtjen e drejtësisë. Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë vendosjen e masave alternative, siç është “Garancia pasurore”, për të cilën ka ofruar dhe dakordësinë. Masat e caktuara kanë cenuar thelbin e lirive dhe të drejtave të tij, në kundërshtim me *nenin 17 të Kushtetutës*.

7.1.4. *Detyrimit për t’u njoftuar brenda një afati sa më të shkurtër për arsyet e arrestimit*, të parashikuar nga neni 28, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 2, i KEDNJ-së, pasi, edhe pse 200 faqe, vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së

së Shkallës së Parë nuk ka dhënë arsyet për arrestimin e tij. Po kështu, gjykatat nuk kanë dhënë arsye se përse ai vazhdon të mbahet padrejtësisht nën masën “Arresti në shtëpi”.

7.1.5. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u liruar në pritje të gjykimit*, të garantuar nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 3, i KEDNJ-së, pasi në rastin e tij nuk ekzistonin kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale. Kështu, duke pasur parasysh personalitetin, ndjenjën e tij morale, strehimin, profesionin, burimet financiare dhe lidhjet familjare, nuk ekzistonte rreziku që ai të largohej. Po kështu, nuk ekzistonte rreziku që ai të pengonte mbarëvajtjen e drejtësisë, pasi hetimet kishin vazhduar për tre vjet dhe prokuroria e gjykatat nuk kishin identifikuar ndonjë veprim konkret për pengimin prej tij të mbarëvajtjes së drejtësisë. Ai nuk kishte qenë ndonjëherë i dënuar, ishte familjar dhe profesor i nderuar.

7.1.6. *Së drejtës për vendimmarrje brenda një afati të shkurtër për ligjshmërinë e masës*, të parashikuar nga neni 5, pika 4, i KEDNJ-së, pasi çështja e tij është shqyrtuar në kundërshtim me kërkesën për shpejtësi të parashikuar nga kjo dispozitë. Ndonëse neni 248, pika 2, i KPP-së parashikon një afat prej 48 orësh, vendimi nr. 116/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë është arsyetuar 15 ditë nga shpallja e tij, çka e bën atë të pavlefshëm në kuptim të nenit 249, pika 7, të KPP-së. Si rrjedhojë e moszbardhjes në kohë të këtij vendimi, ai ka qëndruar në burg pa një vendim të ligjshëm për 14 ditë. Për shkak të kësaj shkeljeje, vendimi i GJKKO-së së Apelit është dhënë pas kalimit të një afati 30-ditor. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është shpallur i arsyetuar brenda afatit ligjor 60-ditor të parashikuar nga neni 448/1 i KPP-së.

7.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.2.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka vendosur për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj tij është shkarkuar në vitin 1996 nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) i drejtuar nga babai i bashkëshortes, shtetasi S.B., për paaftësi në detyrë. Me të ardhur në dijeni të këtij fakti, në seancën e datës 08.11.2023 ai i ka bërë të ditur detyrimin kësaj gjyqtareje për të hequr dorë nga vleftësimi i masës. Kërkesa e tij për përjashtimin e saj nuk është marrë parasysh, në shkelje të hapur të nenit 18, paragrafi 2, të KPP-së. Mosplotësimi i kriterit të gjykatës së paanshme i ka cenuar edhe të drejtën

për t'u dërguar menjëherë përpara një gjyqtari, të parashikuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 3, i KEDNJ-së.

7.2.2. *Së drejtës për hetim e gjykim nga një prokurori dhe gjykatë e pavarur, pasi, sipas neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar (ligji nr. 95/2016), prokurorët e posaçëm dhe gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë nën vëzhgim të një oficeri hetues, i cili mbulon çdo veprimtari të tyre. Ky monitorim, i cili nuk përmban asnjë garanci ligjore ose institucionale dhe është i panevojshëm në një shoqëri demokratike, ngre dyshime serioze për pavarësinë dhe paanshmërinë e këtyre gjyqtarëve, në veçanti të gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë.*

7.2.3. *Së drejtës për t'u hetuar e gjykuar nga një prokurori dhe gjykatë e caktuar me ligj, pasi Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e posaçme nuk kanë qenë kompetente për shqyrtimin e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, për shkak se kjo vepër nuk përfshihet në ato të parashikuara në nenin 75 të KPP-së, kompetente për shqyrtimin e të cilave janë gjykatat e posaçme.*

7.2.4. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe së drejtës për mbrojtje efektive, pasi: (i) nuk është thirrur për t'u pyetur nga prokuroria gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve. Edhe pse hetimet ishin drejtuar dukshëm ndaj tij, organi i ndjekjes penale nuk ka regjistruar emrin e tij, duke shmangur kështu aksesin dhe kontrollin prej tij të hetimeve; (ii) vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë pa u thirrur dhe pa u dëgjuar; (iii) në vlerësimin e masës së caktuar ndaj tij kjo gjykatë nuk i ka dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes ndonëse fashikulli hetimor përmbante rreth 20.000 faqe, të mbledhura nga Prokuroria e Posaçme në më shumë se tre vjet. Gjykata ka refuzuar kërkesën e tij për të shtyrë 24 orë afatin e marrjes në pyetje, duke i dhënë vetëm disa orë kohë për t'u njohur me materialet. Në këto kushte, ai nuk ka pasur kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe për të paraqitur prova ndaj vendimit prej 200 faqesh nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; (iv) në datën 20.10.2023 gjykata e posaçme ka vendosur sekuestrimin e materialeve shkresore dhe kompjuterike të zyrës së financave dhe noterisë ku ai ka depozituar aktet e aktivitetit të tij dhe nuk ka pranuar të lërë kopje*

të tyre, ndërkohë që nuk i ka dhënë akses në këto akte, duke e penguar në realizimin e mbrojtjes efektive.

7.2.5. Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit. Ato nuk kanë treguar veprimet e kundërligjshme të kryera prej tij, mënyrën e realizimit të veprave penale dhe bashkëpunimit ose rolin e tij si bashkëpunëtor. Vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë e shteruese pretendimeve për mungesën e figurës së veprës penale, subjektit të posaçëm, elementeve të paligjshmërisë në përfitimin që pretendohet se është siguruar prej tij, shkaqeve ligjore që kanë justifikuar vendosjen e masës “Arresti në burg”, lidhjes së kufizimit të komunikimeve, takimeve, vizitave personale dhe shoqërore përmes masës “Arresti në shtëpi” me nevojat e sigurimit, sipas parashikimeve të nenit 237 të KPP-së, arsyeve për mospranimin e kërkesës për caktimin e garancisë pasurore, si dhe nuk kanë arsyetuar për shkaqet se përse nuk kanë marrë parasysh pretendimet për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive. Vendimet e GJKKO-së së Shkallës së Parë janë të pavlefshme, në kuptim të nenit 245, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, pasi nuk përmbajnë parashtrimin e shkaqeve se përse nuk janë marrë parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja dhe nuk kanë arsyetuar për përshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit. Në vendimin nr. 116/2023 kjo gjykatë arsyeton se pretendimet e tij janë marrë parasysh në vendimin nr. 112/2023, ndërkohë që kërkuari nuk ka pasur akses në hetim dhe vendimi për caktimin e masës është marrë në dhomën e këshillimit. GJKKO-ja e Apelit ka bërë në vendimin e saj një referencë të pakuptimtë në vendimin unifikues nr. 3/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me bashkëpunimin në veprën penale të vjedhjes në banka. Rasti i interpretuar nga këto kolegje ka të bëjë me subjektet e cilësuar dhe jo ato të posaçme. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për cenimin e lirisë personale, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj, së drejtës për mbrojtje efektive, parimit të kontradiktoritetit, proporcionalitetit të masës, si dhe për interpretimin e zbatimin e gabuar nga gjykatat të dispozitave ligjore procedurale. Vendimi i kësaj gjykate bie në kundërshtim edhe me nenin 14 të Kushtetutës, pasi termat, shprehjet dhe fjalitë e përdorura në të nuk janë në gjuhën shqipe dhe mënyra e analizës nuk përcjell një vazhdimësi mendimi logjik e juridik në

drejtim të konkluzionit të arritur, çka e bën atë të paqartë. Po kështu, ndonëse ekzistonte një tjetër vendim unifikues për bashkëpunimin ndërmjet subjektit të posaçëm dhe atij të përgjithshëm, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ai kishte fuqi vetëm për interpretimin e nenit 175 të KPP-së.

7.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi, në kushtet kur, në mënyrë të gabuar, gjykatat kanë interpretuar nenet 260 dhe 25 të KP-së në kundërshtim me praktikën e mëparshme gjyqësore, Gjykata e Lartë duhet të kishte bërë njësimin e praktikës.

7.4. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj*, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, pasi liria e tij personale është kufizuar për veprime e mosveprime të paparashikuara nga ligji si vepra penale. Caktimi i masës shtrënguese të sigurimit në mungesë të dënueshmërisë së veprimeve përbën dënim pa ligj.

7.5. *E drejta për jetë private dhe familjare*, e garantuar nga neni 36 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së, në lidhje me *parimin e proporcionalitetit*, si dhe *lirinë e lëvizjes*, pasi, në kufizim të jetës së tij familjare dhe shoqërore, pa ligj dhe në mënyrë joproporcionale, GJKKO-ja e Apelit ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke e urdhëruar të mos komunikojë me persona të tjerë, përveç atyre që banojnë me të, pavarësisht se parashikimi ligjor që përcaktonte një kufizim të tillë është shfuqizuar në vitin 2017. Kjo masë ka cenuar lirinë e tij për të përcaktuar në mënyrë të pavarur nga autoriteti shtetëror modalitetet e kontakteve me familjarët ose botën e jashtme. Kufizimi i caktuar është më i fortë edhe se kufizimi i jetës personale familjare të një subjekti në masë sigurimi “Arresti në burg”, ndaj të cilit nenet 37, 40, 49 dhe 50 të ligjit nr. 81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (ligji nr. 81/2020) lejojnë qëndrimin disa orë në ajrim, takimin me familjarët dhe personat jashtë institucionit, kontaktet me median, si dhe ushtrimin e besimit fetar. Modalitetet e mbikëqyrjes së kësaj mase kanë të bëjnë me kontrollin periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit në banesën private, i cili nuk mund të kryhet pa një vendim gjyqësor. Po kështu, përveçse nuk ka lidhje me natyrën e veprës penale për të cilën është hetuar, masa “Arresti në shtëpi” e caktuar ndaj tij ka kufizuar edhe subjekte të tjera, jo pjesë e procedimit penal, në kontaktet me të.

7.6. *Liria e shprehjes*, e garantuar nga neni 22 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ-së, në lidhje me *parimin e proporcionalitetit*, pasi pa ligj dhe në mënyrë

joproporcionale, krahas masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, GJKKO-ja e Apelit i ka kufizuar edhe të drejtën për të mbajtur kontakte me mediat dhe për të shprehur lirisht opinionet e tij. Sipas ligjit nr. 81/2020 edhe të paraburgosurit kanë lirinë e shprehjes, madje institucionet e burgut janë të detyruara të krijojnë kushte për realizimin e kësaj të drejte, e cila mund të kufizohet vetëm për shkak të sigurisë në institucion. Gjykatat nuk kanë arsyetuar lidhjen e ushtrimit prej tij të kësaj lirie me veprën penale dhe nevojat e hetimit. Kufizimi i lirisë është përdorur nga autoritetet shtetërore si mjet për ta penguar në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe organizimit, në kundërshtim me *nenin 18 të KEDNJ-së*.

8. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar:

8.1. Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *lirisë personale* janë të pabazuara, pasi:

8.1.1. Në drejtim të *parimit të ligjshmërisë*, kërkuesi ka shërbyer si hallkë në kalimin e përfitimit të paligjshëm, çka e bën atë bashkëpunëtor me shtetasin S.B., ndaj të cilit rëndon neni 260 i KP-së. Ky i fundit ka pranuar mitë me qëllim që, përmes kërkuesit, t’i kalonte vajzës së tij përfitimet në fjalë. Në këto kushte, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, neni 260 i KP-së gjen zbatim edhe ndaj tij. Po kështu, kërkuesi është përpjekur të veshë përfitimin e paligjshëm me petkun ligjor të dividendit të përfituar nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k. Kjo e fundit është krijuar vetëm për qëllime të dhënies së mitës dhe veprimet e kryera prej saj hedhin dyshime për veprimtari të kundërligjshme. Aktet e kontrollit të organeve shtetërore ngrenë dyshime të arsyeshme për konkluzionin e nxjerrë se veprimtaria e shoqërisë është kryer në përputhje me ligjin.

8.1.2. Ndaj kërkuesit ekzistojnë *dyshime të arsyeshme* për kryerjen e veprave penale. Kështu, përmes pushtetit të ushtruar nga shtetasi S.B. nëpërmjet miratimit të akteve ligjore e nënligjore, vënies në dispozicion të administratës shtetërore për miratimin e akteve individuale, moskryerjes së veprimeve të nevojshme ligjore ose kryerjes së tyre në kundërshtim me parashikimet ligjore, kërkuesi ka përfituar në mënyrë të paligjshme në kthimin e pronave, privatizimin e tyre dhe ndryshimin e destinacionit të zonës.

8.1.3. Në lidhje me pretendimet për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t’u liruar në pritje të gjykimit, familja e kërkuesit disponon pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për të cilat nuk ka të dhëna në deklaratat e pasurisë së bashkëshortes së tij. Në këto kushte, ekziston rreziku që ai të largohet jashtë shtetit, duke pasur parasysh mundësinë e tij ekonomike për ta realizuar këtë.

Po kështu, ekziston mundësia që ai të prishë provat ose të vërë në rrezik marrjen e tyre, si dhe të ndërhyjë te dëshmitarët. Garancia pasurore është e papërshtatshme, duke qenë se kërkuesi dyshohet se ka përfituar rreth 5,000,000 euro mitë. Vepra penale e pastrimit të parave, që dyshohet se ai ka kryer, bën që të ndoten edhe të ardhurat e përfituara prej tij, për sa kohë që nuk është përcaktuar se ato janë të ligjshme.

8.1.4. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për gjykim të shpejtë të masës* janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka pasur mundësinë të ankohej ndaj vendimit për caktimin e saj, vendim të cilin e ka disponuar të arsyetuar. Ky pretendim do të kishte mbështetje vetëm nëse disponimi i gjykatës në vendimin për vlerësimin e masës do të ishte i ndryshëm nga vendimi për caktimin e saj. Moszbardhja e këtij vendimi, sipas nenit 248 të KPP-së, nuk e ka penguar kërkuesin të paraqesë ankim, të drejtë të cilën e ka realizuar në datën 27.10.2023.

8.2. Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* janë të pabazuara, pasi:

8.2.1. Ato për cenimin e *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme* nga gjyqtarja e GJKKO-së së Shkallës së Parë u referohen fakteve për një ngjarje të përfunduar 27 vjet më parë, të cilat nuk mund të shërbejnë për të arritur në konkluzionin e cenimit të kësaj të drejte. Po kështu, gjyqtarja nuk ka ndonjë lidhje hierarkike ose personale me kërkuesin. Nëse shkarkimi i saj nga personi nën hetim S.B. ka ndikuar në paanësinë e saj, kjo duhet të provohet nga kërkuesi. Për më tepër, kërkesa për përjashtimin e saj nuk është bërë në seancën gjyqësore të datës 23.10.2023 dhe kushtet e paanshmërisë nuk i janë sjellë në vëmendje gjyqtarës në këtë seancë, por rreth një muaj më vonë. Ato janë parashtruar nga kërkuesi kur ka ardhur në dijeni të faktit të shkarkimit të saj. Për më tepër, ky pretendim është analizuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka dhënë përgjigje të argumentuar, duke u vlerësuar se nuk gjente mbështetje në ligj dhe në prova.

8.2.2. Për sa i përket *së drejtës për t'u hetuar dhe gjykuar nga prokurori dhe gjykata të pavarura*, ligji nr. 95/2016 ka përcaktuar procedura ligjore strikte dhe garanci gjatë procesit të monitorimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm nga oficeri përgjegjës, përmes vënies në dijeni të një prokurori të papërfshirë në shkelje dhe marrjes së autorizimit nga gjykata, në garantim të së drejtës së tyre për jetë private. Komisioni i Venecias ka vlerësuar se

ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 respektojnë parimet kushtetuese. Ligji nr. 95/2016 ka kaluar filtrin kushtetues gjatë bërjes së tij nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

8.2.3. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, për të pasur lehtësitë e nevojshme dhe për mbrojtje efektive është i pabazuar, pasi vlerësimi në dhomën e këshillimit i kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit parashikohet nga neni 244 i KPP-së, ndërsa nenet 248 dhe 249 të këtij kodi garantojnë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi ose vendimit për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës. Në rastin konkret, kërkuesi është njohur me vendimin e gjykatës për caktimin e masës, kushtet e kriteret që kanë legjitimuar caktimin e saj, si dhe i është dhënë mundësia të paraqesë provat që hidhnin poshtë dyshimin e arsyeshëm gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në lidhje me vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së caktuar ndaj tij, në realizim të së drejtës së mbrojtjes. Pretendimet për mospasjen e kohës së nevojshme për realizimin e mbrojtjes janë të pabazuara, pasi proceset gjyqësore për caktimin dhe vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës janë të ndryshme nga procesi i themelit. Qëllimisht, në lidhje me të parat, ligjvënësi ka përcaktuar afate të shkurta ligjore, ndaj koha e njohjes me aktet, sipas nenit 248 të KPP-së, nuk mund të barazohet me kohën e nevojshme për gjykimet e themelit. Për më tepër, referuar procesverbalit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës për caktimin e masës, rezulton se mbrojtësja e kërkuesit ka qenë e pranishme në ekzekutim, duke treguar se ishte pajisur me kopje të vendimit që në këtë datë. Edhe në seancën e marrjes në pyetje, mbrojtjes i është dhënë sërish kohë për t'u njohur me aktet.

8.2.4. Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë analizuar provat e paraqitura, si dhe bazën ligjore, duke konkluduar në vendimmarrjet respektive. Ato kanë analizuar konceptin e dyshimit të arsyeshëm, si dhe konceptet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit në caktimin e masave. Ka qenë pikërisht kjo analizë që ka çuar në ndryshimin e masës së sigurimit nga GJKKO-ja e Apelit. Fakti që Gjykata e Lartë ka pranuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit nuk e bën të paarsyetuar vendimin e saj. Po kështu, vendimet përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të parashikuara nga neni

245 i KPP-së dhe rezultojnë logjike, pa kundërthënie e përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë se objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, ka vlerësuar se kërkuari legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: *i*) individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*legjitimimi ratione personae*); *ii*) janë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; *iii*) ankimi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*legjitimimi ratione temporis*); *iv*) individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*legjitimimi ratione materiae*) (shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në rastin në shqyrtim, Gjykata evidenton se në përmbajtje të kërkesës kërkuari ka ngritur pretendime për antikushtetutshmërinë e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016. Sipas tij, këto dispozita cenojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

12. Gjykata vëren se kushtetutshmëria e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016, që përcaktojnë kontrollin e plotë e periodik të të dhënave që përfshihen në konceptin e të dhënave private, i është nënshtruar më parë kontrollit kushtetues përkundrejt garancive që ofrojnë parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës, të sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata ka vlerësuar se regjimi i kontrollit periodik të komunikimeve të gjyqtarëve të

gjykatave të posaçme autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës dhe se ligji nr. 95/2016 përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën se si realizohet kontrolli, pasi rezultatet e kontrollit eventual janë objekt vlerësimi nga gjykata në rastet e procedimit penal dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastet e procedimeve disiplinore. Po sipas Gjykatës, kuadri ligjor në fuqi, që rregullon statusin e magjistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shtesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit tyre, ku përfshihet sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimi dhe trajtimi i posaçëm i tyre (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, duke pasur parasysh se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të posaçëm, si rrjedhojë e monitorimit të veprimtarisë së tyre, i janë nënshtruar vlerësimit kushtetues dhe janë bërë objekt i vendimmarrjes së mëparshme kushtetuese, duke u gjendur të pabazuara, Gjykata çmon se ato nuk mund të merren në shqyrtim.

14. Po kështu, në jurisprudence të saj Gjykata ka theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, edhe në rastin e ankimeve kushtetuese individuale që kanë të bëjnë me masat e sigurimit personal kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione personae*, Gjykata evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime për përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të vendosur ndaj tij nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe të zbatuar për periudhën 21.10.2023 - 21.11.2023. Gjykata vëren se proporcionaliteti i kësaj mase është bërë objekt vlerësimi nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka ndryshuar vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, të verifikuar me vendimin nr. 116/2023 të kësaj gjykate, duke vendosur ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë të nevojave të sigurimit. Masa e vendosur nga GJKKO-ja e Apelit dhe e zbatuar menjëherë ndaj kërkuesit është në fuqi në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, pasi rekursi i kërkuesit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Në këto kushte, ndërsa pretendimet e kërkuesit në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës “Arresti në burg” janë marrë në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat, në ushtrim të kontrollit të tyre subsidiar

ndaj vendimmarrjes së GJKKO-së së Shkallës së Parë, i kanë vlerësuar ato të bazuara duke konstatuar shkelje nga kjo e fundit, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për këto pretendime, për shkak se pasojat e drejtpërdrejta dhe reale të masës “Arresti në burg” nuk ekzistojnë më, pasi janë riparuar brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm. Ndërsa lidhur me pretendimet për masën “Arresti në shtëpi”, të dhënë nga GJKKO-ja e Apelit, për sa kohë ajo është zbatuar dhe ka mbetur në fuqi edhe pas kontrollit subsidiar të Gjykatës së Lartë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

16. Po kështu, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* në aspektin substancial edhe për sa u përket pretendimeve se masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” ka kufizuar edhe subjekte të tjera, jo pjesë e procedimit penal, në kontaktet me të. Kjo për shkak se këto pretendime, në mënyrën se si janë parashtruar, kanë të bëjnë me të drejtat e personave të tjerë, ndaj në lidhje me to kërkuesi nuk ka arritur të provojë interesin e ligjshëm vetjak të tij, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000.

17. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se vendimet për vendosjen e masave të sigurimit personal që prekin lirinë personale të individit, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për sa kohë që janë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe janë shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur në lidhje me të drejtën e pretenduar si të cenuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duke e lidhur atë me gjyqtaren e GJKKO-së së Shkallës së Parë që ka vendosur për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të shkarkuar në vitin 1996 për paaftësi në detyrë nga KLD-ja e drejtuar nga vjehri i tij, në cilësinë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Sipas tij, kërkesa që ai ka paraqitur për përjashtimin e kësaj gjyqtareje nuk është marrë parasysh dhe si pasojë e njëanshmërisë së saj i është cenuar edhe e drejta për t’u dërguar menjëherë përpara një gjyqtari.

19. Në analizë të materialeve të depozituara së bashku me kërkesën dhe atyre të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se në procesin gjyqësor të kundërshtuar kërkuesi nuk ka ngritur pretendime për paanshmërinë e gjyqtarës së hetimit paraprak gjatë marrjes në pyetje prej saj për qëllime të vlerësimit të masës “Arresti në burg” të caktuar ndaj tij dhe as ka kërkuar përjashtimin e saj. Po ashtu, në ankimin e datës 13.11.2023 kundër vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit, ai ka pretenduar cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në mënyrë të përgjithshme, por pa specifikuar shkaqe konkrete. Shkarkimi nga detyra në vitin 1996 i gjyqtarës së hetimit paraprak, si shkak papajtueshmërie për ushtrimin e funksionit nga ana e saj, është parashtruar për herë të parë nga ai në rekursin e datës 22.01.2024 drejtuar Gjykatës së Lartë. Gjykata vëren, gjithashtu, se paralelisht me këtë proces kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës “Arresti në burg” të caktuar me vendimin nr. 112/2023 dhe çështja është shqyrtuar po nga ajo gjyqtare e hetimit paraprak. Në këtë proces, në seancën e datës 08.11.2023, kërkuesi i ka kërkuar gjyqtarës të hiqte dorë nga shqyrtimi i çështjes, duke artikuluar si shkak shkarkimin e saj nga detyra në vitin 1996 nga babai i bashkëshortes, çka nuk është çmuar të parashtrohet nga gjyqtarja në fjalë, ndërsa në vijim, përmes mbrojtësve të tij, kërkuesi është shprehur se do të paraqiste kërkesë për përjashtimin e saj në përfundim të seancës gjyqësore (*shih faqen 2 të procesverbalit të seancës së datës 08.11.2023 të GJKKO-së të Shkallës së Parë*), por, megjithatë, nga aktet e paraqitura në këtë gjykim kushtetues, nuk rezulton që një kërkesë e tillë të jetë paraqitur.

20. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme nuk është ngritur nga kërkuesi sipas procedurës standarde, gjatë procesit të caktimit dhe verifikimit të zbatimit të masës “Arresti në burg”, por në një tjetër proces të zhvilluar pas tij, konkretisht atij për shuarjen e kësaj mase. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se mosparaqitja e një kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, sipas parashikimeve të dispozitave procedurale, pra sipas procedurës standarde për këtë qëllim, do të konsiderohet si mosshkrim nga kërkuesi i mjeteve juridike efektive në dispozicion (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 67, datë 03.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në kushtet kur në procesin objekt gjykimi kushtetues kërkuesi nuk ka përdorur mjetet juridike efektive në dispozicion për pretendimin për njëanshmërinë e gjykatës, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Me të njëjtat argumente, Gjykata çmon se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u dërguar përpara

një gjyqtari, i cili ka të bëjë me njëanshmërinë e gjyqtares në fjalë, nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e *parimit të ligjshmërisë*, si dhe të *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj*, për shkak se liria e tij personale është kufizuar për veprime e mosveprime të paparashikuara nga ligji si vepra penale. Sipas tij, ai nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë” dhe veprimet e kryera prej tij si ortak i shoqërisë tregtare “Homeplan” sh.p.k. nuk përbënin as veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

22. Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e *parimit të ligjshmërisë* dhe *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj*, në thelb, kanë të bëjnë me ekzistencën e elementeve të figurës së atyre veprave. Si të tilla, ato mund të parashtrohen përpara gjykatave penale gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale, ku kërkuesi ka mundësinë që të paraqesë çdo pretendim dhe provë si në lidhje me faktin penal dhe cilësimin juridik të tij, ashtu edhe me juridiksionin e gjykatave. Në këto kushte, Gjykata çmon se në lidhje me këto pretendime kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor të caktimit dhe zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit personal në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

24. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 05.03.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 26.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

25. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* në ankimin kushtetues individual, kërkuesi i ka parashtruar pretendimet e tij të grupuara në drejtim të cenimit të: (a) së drejtës për proces të rregullt ligjor, (b) lirisë personale, (c) së drejtës për jetë private dhe familjare dhe (d) lirisë së shprehjes. Në lidhje me to, Gjykata vëren se për sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor, ai ka pretenduar cenimin e saj në drejtim të: (i) së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, (ii) së drejtës për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur, (iii) së drejtës për mbrojtje efektive dhe (iv) standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Ndërsa në lidhje me lirinë personale kërkuesi ka pretenduar cenimin e saj në drejtim të: (i) mungesës së dyshimeve

të arsyeshme për kufizimin e saj, (ii) proporcionalitetit në caktimin e masës, (iii) mosnjoftimit brenda një afati të shkurtër të arsyeve të arrestimit, (iv) së drejtës për t'u liruar në pritje të gjykimit dhe (v) së drejtës për vendimmarrje brenda një afati të shkurtër për ligjshmërinë e masës.

26. Duke pasur parasysh qasjen e saj në drejtim të rasteve përjashtimore për kontrollin e vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, siç janë dhe vendimet që caktojnë masat e sigurimit personal, Gjykata ka pohuar se ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale. Ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Ndërkohë që aspekti substancial i lirisë personale mbrohet nga neni 27 i Kushtetutës, për aspektin procedural të kësaj lirie, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura. Po sipas Gjykatës, garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 19, datë 04.04.2023*), sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, procedura e parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 5 të KEDNJ-së, kur është rasti, duhet të plotësojë të njëjtat garanci si ato të kërkuara në nenin 6 § 1 të Konventës për çështjet penale ose civile, dhe ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për llojin e heqjes së lirisë në fjalë (*shih Iladov k. Rusisë [DHM], datë 22.02.2012, § 161; A. dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], 2009, § 203; Reinprecht k. Austrisë, datë 13.11.2005, § 31*).

28. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se aspekti substancial i lirisë personale duhet analizuar nën dritën e nenit 27 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa aspekti procedural i saj nën atë të nenit 28 të saj të lidhur me nenin 42.

29. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se argumentet në thelb të pretendimeve të kërkuarit lidhen me lirinë personale dhe se, për sa i përket procesit gjyqësor të kundërshtuar

që ka çuar në cenimin e kësaj lirie, ato parashtrohen edhe në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, Gjykata çmon ta shqyrtojë çështjen në vijim në drejtim të: (a) *lirisë personale*, si në aspektin procedural, lidhur me *garancitë për një proces të rregullt ligjor*, sipas neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe në aspektin substancial, lidhur me kushtet dhe kriteret që e lejojnë kufizimin e kësaj lirie. Po kështu, Gjykata çmon të analizojë edhe pretendimet e kërkuarit për (b) *cenimin e së drejtës për jetë private dhe familjare* dhe (c) *lirisë së shprehjes*.

30. Gjykata vëren se kërkuari, në kuadër të *lirisë personale në aspektin procedural*, ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, duke pretenduar, ndër të tjera, se, bazuar në nenin 28, pika 3, të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 3, të KEDNJ-së, ai ka të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Gjykata vëren se periudha e paraburgimit të kërkuarit ka filluar në datën 21.10.2023, kur ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit e arrestit në burg dhe prej datës 21.11.2023 ai është nën masën e sigurimit të arrestit në shtëpi. Po ashtu, Gjykata vëren se objekti i gjykimit kushtetues lidhet me vendimet gjyqësore që janë dhënë për caktimin e masës së sigurimit të arrestit ndaj kërkuarit dhe jo me kërkesa të tjera për zëvendësimin apo revokimin e masës. Duke mbajtur në konsideratë objektin e gjykimit, faktet konkrete të çështjes penale për të cilat është caktuar masa e sigurimit në raport me kohëzgjatjen dhe llojin e paraburgimit, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar i lirë në pritje të gjykimit është haptazi i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të merret në shqyrtim.

31. Për sa i përket *së drejtës për t'u njoftuar brenda një afati sa më të shkurtër për arsyet e arrestimit*, kërkuari ka pretenduar cenimin e saj për shkak se vendimi për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit "Arresti në burg" nuk ka dhënë arsyet e arrestimit të tij. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, e ka prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se kërkuari është njohur me vendimin e gjykatës, në të cilin janë përcaktuar kushtet e kriteret që kanë legjitimuar caktimin e saj, si dhe i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë.

32. Gjykata vëren se neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5, pika 2, i KEDNJ-së përcaktojnë detyrimin për njoftimin menjëherë të individit, të cilit i është hequr liria personale, për arsyet e kufizimit të kësaj lirie. Për sa i përket këtij detyrimi, në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka theksuar se ai vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh rrethanat specifike të secilës çështje dhe se nuk kërkon domosdoshmërisht informimin e të pandehurit për të gjitha shkaqet në momentin e arrestimit (*shih Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë [DHM], datë 15.12.2016, § 115*).

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin ndaj kërkuarit të masës "Arresti në burg" është ekzekutuar ditën e

nesërme, konkretisht në datën 21.10.2023. Ky veprim është dokumentuar me procesverbal, në të cilin pasqyrohet edhe se kërkuesit “iu bë komunikimi i vendimit”, përveçse edhe se gjatë komunikimit të masës së sigurimit ka qenë e pranishme edhe avokatja e zgjedhur prej tij. Procesverballi është nënshkruar pa vërejtje nga kërkuesi dhe mbrojtësjja e tij. Referuar nenit 246, pika 1, të KPP-së, oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe e njeh menjëherë me letrën e të drejtave, sipas paragrafit 2 të nenit 34/b të këtij kodi dhe Policia Gjyqësore mban procesverbal për veprimet e kryera. Nisur nga sa rezulton, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mosnjohimin e arsyeve të arrestit nuk gjen mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, ndaj është haptazi i pabazuar.

34. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për vendimmarrje brenda një afati të shkurtër për ligjshmërinë e masës, të parashikuar nga neni 5, pika 4, i KEDNJ-së, për shkak se çështja e tij është shqyrtuar në kundërshtim me kërkesën për shpejtësi, pasi, pavarësisht nga parashikimet e nenit 248, pika 2, të KPP-së, vendimi nr. 116/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë është arsyetuar 15 ditë nga shpallja e tij, çka e bën atë të pavlefshëm në kuptim të nenit 249, pika 7, të KPP-së, për pasojë ai ka qëndruar në burg pa një vendim të ligjshëm për 14 ditë, ndërsa vendimi i GJKKO-së së Apelit është dhënë pas 30 ditësh. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, e ka prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se mosarsyetimi i vendimit nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në afatin e përcaktuar nga neni 248 i KPP-së, nuk e ka penguar kërkuesin të paraqesë ankim, duke realizuar kështu të drejtën e tij.

35. Gjykata vëren se sipas nenit 28, pika 2, të Kushtetutës, personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi “c”, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. Po kështu, sipas nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së, çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë, me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

36. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se për qëllime të vlerësimit të shpejtësisë së gjykimit të ligjshmërisë së masës, të përcaktuar në nenin 5, pika 4, të KEDNJ-së, zbatohen të njëjtat kritere si në rastet e neneve 5, pika 3 dhe 6, pika 1, të KEDNJ-së (*shih Mooren kundër Gjermanisë (DHM), datë 09.07.2009, § 106*). Në këndvështrim të parashikimeve të nenit 28 të Kushtetutës dhe neneve 246 e vijues të KPP-së, Gjykata vëren se në rastin e heqjes së lirisë personale, periudha që merret në konsideratë për këtë qëllim fillon

nga momenti i zbatimit të masës dhe përfundon në momentin kur vendimi që ka vendosur për ligjshmërinë e saj, përfshirë edhe apelimet, bëhet përfundimtar.

37. Sipas nenit 248, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, verifikimi i kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës dhe nevojave të sigurimit bëhet nga gjykata, përmes marrjes në pyetje të personit ndaj të cilit është vendosur arresti në burg ose në shtëpi, brenda tri ditëve nga caktimi i masës dhe vendimi i saj jepet i arsyetuar brenda 48 orëve. Ndërsa neni 249 i këtij kodi parashikon të drejtën e ankimit brenda pesë ditësh ndaj vendimit për caktimin e masës (pika 1), ashtu dhe ndaj vendimit për vazhdimin e zbatimit të masës (pika 1/1), detyrimin e sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin për realizimin e njoftimeve përkatëse dhe, në vijim, dorëzimin e akteve në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin brenda tre ditëve nga realizimi i njoftimeve (pika 3), shqyrtimin e ankimit nga gjykata e apelit brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim të akteve (pika 5) dhe depozitimin nga ajo të vendimit të arsyetuar brenda 10 ditëve (pika 6), si dhe humbjen e fuqisë së aktit në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese, kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar (pika 7). Pra, në këndvështrim të këtyre rregullimeve ligjore, Gjykata vë në dukje se KPP-ja ka përcaktuar afate të shkurta/shpejta në funksion të së drejtës për liri personale të individit, në kuptimin që paraburgimi ose jo i tij të vendoset në një kohë sa më të shpejtë nga gjykata, duke i garantuar atij të drejtën e ankimit dhe kontrollit të vendimit të saj nga gjykata më e lartë brenda një afati të shkurtër kohor.

38. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata evidenton se kërkuesi kundërshton kohëzgjatjen e arsytimit të vendimit nr. 116/2023 nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e cila sipas tij ka çuar në pavlefshmërinë e atij vendimi, duke e bërë të paligjshëm qëndrimin e tij në paraburgim, ndërsa vendimi i GJKKO-së së Apelit është dhënë pas 30 ditëve. Në referim të materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se kërkesa për caktimin e masës “Arresti në burg” është paraqitur nga organi i ndjekjes penale. Ajo është shqyrtuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në dhomën e këshillimit në datën 20.10.2023, duke u vendosur në përfundim pranimit të saj. Vendimi i caktimit të masës i është komunikuar kërkuesit në datën 21.10.2023, në momentin e zbatimit të masës dhe ankimi i tij ndaj këtij vendimi është regjistruar në GJKKO-në e Shkallës së Parë në datën 22.10.2023. Në vijim, në datën 23.10.2023 kjo gjykatë ka marrë në pyetje kërkuesin, sipas parashikimeve të nenit 248 të KPP-së, duke vendosur në përfundim vazhdimin e zbatimit të masës së caktuar ndaj tij, ndërsa në datën 27.10.2023 kërkuesi ka depozituar ankim ndaj këtij vendimi. Ndërkohë, vendimi i arsyetuar i gjykatës për vazhdimin e zbatimit të masës u është komunikuar mbrojtësve të kërkuesit në datën 08.11.2023, ndërsa në datën 10.11.2023 kërkuesit. Sekretaria gjyqësore e GJKKO-së së Shkallës së Parë ka realizuar njoftimet përkatëse të ankimeve të

kërkuesit dhe në datën 14.11.2023 ka përcjellë dosjen gjyqësore në GJKKO-në e Apelit, ku çështja është regjistruar po në këtë datë. Kjo e fundit, në vijim, në datën 21.11.2023 ka shqyrtuar ankimet e kërkuesit (*shih faqet 2 dhe 5-6 të dosjes gjyqësore nr. 116/2023 (Ankime) të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe faqen 1 të dosjes gjyqësore të GJKKO-së së Apelit*).

39. Po kështu, Gjykata konstaton se fakti i mosarsyetimit brenda afatit ligjor 48-orësh të vendimit për vazhdimin e masës nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë është parashtruar nga kërkuesi në ankimin e tij drejtuar GJKKO-së së Apelit. Kjo e fundit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet në ankim për pavlefshmërinë e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për mungesë arsytimi, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs në lidhje me afatet e gjykimit nuk cenojnë vendimmarrjen objekt rekursi, pasi gjykatat kanë shqyrtuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme dhe kanë marrë në pyetje kërkuesin brenda afatit të arsyeshëm dhe në përputhje me dispozitat e KPP-së, që rregullojnë shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre (*shih faqen 81, paragrafi 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

40. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se, në përputhje me parashikimet e nenit 248, pika 1, të KPP-së, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuesin dhe ka shpallur vendimin e saj në datën 23.10.2023, brenda afatit të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji procedural penal, ndërsa ai ka marrë dijeni për vendimin e saj për vazhdimin e masës në po këtë datë, pasi ka qenë personalisht i pranishëm në gjykim, përveçse i përfaqësuar nga mbrojtësit e tij. Në vijim, ndonëse vendimi i gjykatës nuk është depozituar i arsyetuar brenda afatit ligjor prej 48 orësh, kërkuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit në datën 27.10.2023, ndërkohë që pas vënies në dispozicion të vendimit të arsyetuar të gjykatës, ai ka plotësuar ankimin në datën 13.11.2023. Pas realizimit të njoftimeve përkatëse nga sekretaria gjyqësore, ankimi i kërkuesit është shqyrtuar nga GJKKO-ja e Apelit në datën 21.11.2023, brenda afatit ligjor 10-ditor, duke shpallur ajo vendimin në këtë datë.

41. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vlerëson se vonesa e GJKKO-së së Shkallës së Parë për depozitimin e arsyetuar të vendimit të shpallur prej saj për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk përcaktohet nga ligji procedural penal me pasojë pavlefshmërinë e tij. Megjithatë, kjo vonesë, pavarësisht se nuk e ka penguar kërkuesin për ushtrimin e së drejtës së ankimit, praktikisht ka ndikuar në afatin brenda të cilit vendimi i gjykatës së shkallës së parë është kontrolluar nga gjykata më e lartë. Gjithsesi, në pikëpamje të pasojës, vonesa në depozitimin të arsyetuar të vendimit nga gjykata e shkallës së parë, pra ligjshmëria e qëndrimit të kërkuesit në paraburgim gjatë periudhës së vonesës, duket se ka marrë përgjigje nga GJKKO-ja e Apelit, sipas së cilës paraburgimi i kërkuesit është cilësuar i paligjshëm që prej momentit të zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se procesi gjyqësor nga momenti i zbatimit të masës së sigurimit për paraburgimin e

kërkuesit (datë 21.10.2023) dhe deri në momentin kur GJKKO-ja e Apelit ka shqyrtuar dhe vendosur për ankimet e tij ka zgjatur 30 ditë, afat i cili nuk duket që të bjerë ndesh me kërkesën për shpejtësi të nenit 28 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së. Po ashtu, pavarësisht shkeljes së lejuar të ligjit nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në lidhje me afatin e depozitimit të vendimit të arsyetuar, për sa kohë pasoja e pretenduar e kësaj shkeljeje është korigjuar nga gjykata më e lartë, pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i pabazuar.

42. Po ashtu, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkuesit për mosshpalljen e vendimit nga Gjykata e Lartë brenda afatit ligjor 60-ditor nuk mund të merret në shqyrtim, për sa kohë që e drejta e tij për të paraqitur ankim kushtetues individual nuk është cenuar për këtë shkak.

43. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të hetimit dhe gjykimit nga një prokurori e gjykatë e caktuar me ligj*. Sipas tij, prokuroria dhe gjykatat e posaçme nuk kanë qenë kompetente për shqyrtimin e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, pasi kjo vepër nuk përfshihet në ato të parashikuara në nenin 75 të KPP-së. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur prapësime në këtë drejtim.

44. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata vëren se kërkuesi është hetuar penalisht për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së. Neni 79 i KPP-së përcakton rastet e bashkimit të procedimeve, ku përfshihen edhe ato kur një person dyshohet për kryerjen e disa veprave penale, siç është edhe rasti konkret, ndërsa neni 80 i këtij kodi parashikon bashkimin e procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Kështu, sipas nenit 80 të KPP-së, në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe procedimet e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në kushtet kur vepra penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” është në kompetencë të prokurorisë dhe gjykatave të posaçme, si dhe duke pasur parasysh se vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” është pretenduar në lidhje me veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, Gjykata çmon se në rastin e kërkuesit nuk ka shkelje të rregullave ligjore që përcaktojnë kompetencën e gjykatës, për rrjedhojë e vlerëson haptazi të pabazuar këtë pretendim të tij.

45. Po kështu, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit/njohjes me dokumentet*, si rrjedhojë e sekuestrimit të materialeve shkresore dhe

kompjuterike të zyrës së financave dhe noterisë ku ai ka depozituar aktet e aktivitetit të tij, Gjykata vëren se në lidhje me çështjen nga ana e organit të akuzës janë bërë dy sekuestime në data të ndryshme. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar sekuestron e dytë, rezultatet e së cilës nuk kanë shërbyer për caktimin ndaj tij të masave të sigurimit objekt i kontrollit kushtetues konkret. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit/njohjes me dokumentet në procesin që ka vendosur masën e sigurimit ndaj tij janë haptazi të pabazuara.

46. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit*, si rrjedhojë e mosnjohjes së praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë, pavarësisht interpretimit të neneve 260 dhe 25 të KP-së nga gjykatat më të ulëta në kundërshtim me praktikën gjyqësore, pretendim për të cilin Prokuroria e Posaçme nuk ka parashtruar ndonjë prapësim. Gjykata, duke ritheksuar se cilësimi juridik i veprave penale ka të bëjë me themelin e çështjes (*shih paragrafin 24 të vendimit*), vëren se mënyra e interpretimit të dispozitave të KPP-së nga ana e Gjykatës së Lartë nuk duket të jetë arbitrare apo në kundërshtim me praktikën gjyqësore. Po në këtë drejtim, kërkuesi nuk ka paraqitur vendime gjyqësore për raste analoge me vendimmarrje të ndryshme nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për më tepër, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se njësimi i praktikës gjyqësore përfshihet në kompetencat që neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), ndaj në këtë këndvështrim e vlerëson të pabazuar *ratione materiae* këtë pretendim të kërkuesit.

47. Kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e së drejtës familjare*, sepse masa e sigurimit i ka kufizuar mundësinë për të zhvilluar e ruajtur në një masë të caktuar marrëdhëniet familjare. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës kjo e drejtë ka si qëllim kryesor të drejtën e individit për të jetuar së bashku me familjarët e tij, në mënyrë që marrëdhëniet familjare të zhvillohen normalisht dhe që anëtarët e familjes të gëzojnë praninë e njëri-tjetrit (*shih Marckx kundër Belgjikës, 13.01.1979, § 31 dhe Olsson kundër Suedisë (no. 1), 24.03.1988, § 59*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e së drejtës për jetë familjare në aspektin kushtetues, në kuptim të marrëdhënieve familjare konkrete të cenuara si rrjedhojë e caktimit ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

48. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon t’i analizojë ato në themel në kuadër të *lirisë personale në (a) aspektin procedural dhe (b) në aspektin substancial. Lirinë personale në aspektin procedural* Gjykata çmon ta analizojë në drejtim të: (i) së drejtës për t’u dëgjuar të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive dhe (ii) standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me qartësinë e tij edhe në drejtim të nenit 14 të Kushtetutës. Lirinë personale

në aspektin substancial Gjykata do ta vlerësojë në drejtim të: (i) mungesës së dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale dhe (ii) parimit të proporcionalitetit. Po ashtu, Gjykata çmon të analizojë edhe pretendimet e kërkuarit lidhur me cenimin e (iii) së drejtës për jetë private dhe (iv) lirisë së shprehjes. Për sa i përket kësaj të fundit, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit parashtrihen në kuadër të lirisë së korrespondencës dhe të komunikimit, të garantuar nga neni 36 i Kushtetutës, ndaj, bazuar në parimin *iura novit curia*, vlerëson t'i analizojë ato në drejtim të së drejtës për jetë private.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

B.1.1. Për cenimin e lirisë personale në aspektin procedural

49. Gjykata çmon që ta analizojë fillimisht lirinë personale në aspektin procedural, duke u ndaluar tek analiza e pretendimeve të kërkuarit për cenimin e a) së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e mosthirrjes për t'u pyetur gjatë caktimit të masës "Arresti në burg" dhe mospjesëmarrjes në procesin e caktimit të masës (shqyrtimit të saj në dhomën e këshillimit), b) së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me mospasjen e kohës së nevojshme për t'u njohur me dokumentet dhe aktet, si dhe në kuadër të aspektit procedural të lirisë personale edhe pretendimet që lidhen me c) standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

a) Për të drejtën për t'u dëgjuar

50. Në drejtim të aspektit procedural të lirisë personale, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar: cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e mosthirrjes për t'u pyetur nga prokuroria dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë gjatë procesit të caktimit të masës "Arresti në burg" dhe marrjes së vendimit nga kjo e fundit në dhomën e këshillimit. Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se masat e sigurimit vendosen nga gjykata bazuar në kërkesën e prokurorit, vendim i cili merret në dhomën e këshillimit dhe jepet i arsytuar, ndërsa verifikimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës bëhet nga gjykata përmes marrjes në pyetje të personit të arrestuar, të drejtë të cilën kërkuari e ka ushtruar lirisht.

51. Gjykata vëren se neni 28, pika 2, i Kushtetutës parashikon se personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. Gjykata thekson se një ndër qëllimet e kësaj dispozite kushtetuese është edhe garantimi i së drejtës së personit të cilit i është kufizuar liria personale për t'u dëgjuar nga gjykata në lidhje me pretendimet e tij, si dhe për t'u mbrojtur ndaj çdo kufizimi të padrejtë e arbitrar të kësaj lirie.

52. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, sipas rastit, duhet të përmbushen nga organet e pushtetit publik, përfshirë gjykatat, nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore procedurale. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar këto organe, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi i pushtetit publik ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 48, datë 11.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Gjykata vë në dukje se e drejta e personit që i hiqet liria për vlerësim gjyqësor të ligjshmërisë së masës së ndalimit parashikohet, gjithashtu, në nenin 5, pika 4, të KEDNJ-së. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka theksuar se kjo e drejtë, e cila përbën edhe *habeas corpus*-in e KEDNJ-së, qëndron në thelb të garancive që ofron neni 5, pika 4, i KEDNJ-së (*shih Mooren k. Gjermanisë, datë 09.07.2009, § 106; Rakevich k. Rusisë, datë 28.10.2003, § 43*). Një person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së masës, nën dritën jo vetëm të kërkesave ligjore kombëtare, por, gjithashtu, dhe të KEDNJ-së, parimeve të përgjithshme të shprehura në të dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5. Shqyrtimi duhet të shtrihet mbi ato kritere, të cilat janë thelbësore për vlerësimin e ligjshmërisë, sipas llojit të masës së caktuar (*shih Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 20.02.2003, § 65*), si dhe duhet të garantojë parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i dhënë të ndaluarit mundësi efektive për të kundërshtuar dyshimet ose akuzat ndaj tij (*shih A. dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], datë 19.02.2009, § 31*).

54. Po ashtu, Gjykata vë në dukje se, bazuar në parashikimet e neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, neni 244 i KPP-së ka parashikuar se masa e sigurimit vendoset nga gjykata mbi bazën e kërkesës së arsyetuar të prokurorit dhe vendimi merret në dhomën e këshillimit. Neni 245 i KPP-së përcakton kriteret që duhet të plotësojë vendimi që cakton masën e sigurimit, ndërsa sipas nenit 248 të KPP-së, jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi.

55. Në kuadër të parashikimeve kushtetuese e ligjore dhe jurisprudencës së mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u marrë në pyetje, duke u ndaluar fillimisht në analizën nëse është respektuar parashikimi i nenit 28, pika 2, të Kushtetutës lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar përpara gjyqtarit në afatin e caktuar kushtetues. Po kështu, Gjykata do të analizojë nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar, nëse i janë krijuar kushtet për të bërë deklaratimet, parashtrimin e fakteve, vlerësimin ligjor të tyre gjatë gjykimit për ligjshmërinë e

caktimit dhe vlerësimit të masës së sigurimit, si dhe nëse pretendimet e tij për cenimin e këtyre të drejtave kanë marrë përgjigje nga GJKKO-ja e Apelit e Gjykata e Lartë.

56. Gjykata vëren se vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës “Arresti në burg” është marrë në *dhomën e këshillimit*, në mungesë të kërkuarit dhe përfaqësuesit të tij dhe është ekzekutuar të nesërmen në datën 21.10.2023. Në ankimet ndaj vendimeve nr. 112/2023 e nr. 116/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe në rekurs kërkuar ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, për shkak të shqyrtimit nga gjykata në dhomën e këshillimit të kërkesës së prokurorisë për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit.

57. Gjykata vëren, gjithashtu, se brenda afatit 48-orësh të parashikuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuarin për qëllime të vlerësimit të vendimit të saj nr. 112/2023. Për sa u përket pretendimeve të kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar në procesin e caktimit të masës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vënë në dukje se neni 248 i KPP-së rregullon procedurën kur gjykata vendos një masë sigurimi personal shtrënguese ose ndaluese pa e dëgjuar paraprakisht personin e dyshuar (në mungesë, në dhomën e këshillimit, bazuar vetëm në kërkesën e organit të akuzës). Sipas gjykatës, kjo dispozitë normon procedurën e marrjes në pyetje të kërkuarit për t’i dhënë mundësinë të japë shpjegime e deklarime që i çmon të nevojshme për pyetjen e tij lidhur me faktet penale që i atribuohen, garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe zhvillimin e gjykimit mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit pas marrjes së provave të parashtruara nga personi nën hetim, ndaj të cilit është caktuar masa (*shih faqen 7 të vendimit nr. 116/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

58. Ky qëndrim i GJKKO-së së Shkallës së Parë është vlerësuar i drejtë nga GJKKO-ja e Apelit, sipas së cilës, në përmbushje të të drejtave të personit ndaj të cilit, në kushtet e fshehtësisë, është caktuar një masë sigurimi, neni 248 i KPP-së ka përcaktuar marrjen në pyetje të personit si detyrim të gjykatës për të qenë në kontakt të menjëhershëm me të. Ky detyrim paraqet rëndësi në kontrollin e zbatimit të masës së sigurimit, si dhe në garantimin e të drejtave të individit, duke qenë në funksion të procesit të rregullt ligjor dhe zbatimit të parimit të kontradiktoritetit dhe në këtë seancë kërkuar dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtën e qasjes në aktet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit, mbi të cilat është vendosur caktimi i masës (*shih faqen 13 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Ndërsa, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuar ka marrë përgjigje argumentuese dhe ezauruese për pretendimet e tij nga GJKKO-ja e Apelit (*shih faqen 80, pika 39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

59. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuar nuk është arrestuar në flagrancë ose ndaluar me urdhër të prokurorit dhe masa e sigurimit është caktuar ndaj tij bazuar në nenet

228, 229, 230, 232, pika 1, shkronja “dh”, 238, 244 e 466 të KPP-së. Kjo procedurë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, sipas nenit 244 të KPP-së, ndërsa e drejta e individit për t’u dëgjuar garantohet nga procedura e marrjes në pyetje të tij, e cila, sipas nenit 248 të KPP-së, duhet zhvilluar brenda tri ditëve, çka është në përputhje me afatin prej 96-orësh të parashikuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe me përcaktimet e nenit 5, pika 4, të KEDNJ-së. Procedurat e parashikuara nga këto dispozita rezulton të jenë respektuar edhe në rastin konkret, ku në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore kërkuesi është marrë në pyetje për qëllime të vlerësimit të masës së caktuar, në prani të tij dhe të mbrojtjes së tij, duke iu dhënë mundësia të shprehet për faktet, provat, vlerësimet ligjore dhe deklaratimet e organit të ndjekjes penale në mënyrë të barabartë me të. Po kështu, pretendimet e tij për caktimin e masës në dhomën e këshillimit kanë marrë përgjigje, në thelb, nga GJKKO-ja e Apelit e Gjykata e Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për shqyrtimin nga gjykata të kërkesës së prokurorisë për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në burg” në dhomën e këshillimit është i pabazuar.

60. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuesit se nuk është marrë në pyetje nga ana e prokurorisë gjatë fazës së hetimeve, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se emri i tij është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në datën 02.10.2023 dhe se masa i është caktuar në datën 20.10.2023, e vlerëson atë të pabazuar.

b) Për të drejtën për mbrojtje efektive

61. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, si rrjedhojë e mospasjes së kohës së nevojshme për realizimin e mbrojtjes në procesin e vlerësimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”. Prokuroria e Posaçme e ka prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se afatet procedurale në gjykimet e masave të sigurimit janë të ndryshme nga gjykimet penale të themelit dhe se në seancën e marrjes në pyetje mbrojtësve të tij u është dhënë kohë për t’u njohur me aktet. Po sipas prokurorisë, mbrojtësja e kërkuesit ka qenë e pranishme në ekzekutimin e masës së caktuar ndaj tij, duke treguar se ishte pajisur me kopje të vendimit që në këtë datë. Kërkuesi ka kundërpapësuar se ndonëse mbrojtja ka qenë e pranishme në ekzekutim, asaj nuk i është vënë në dispozicion kopje e vendimit.

62. Për sa u përket afateve të shpejta procedurale të veprimit të gjykatave në kontekstin e vendosjes së masave të sigurimit dhe pasojave të tyre mbi të drejtën e kërkuesit për mbrojtje efektive, Gjykata vëren se këto afate të shpejta imponohen nga përmbajtja e neneve 248, pika 3 dhe 249 të KPP-së. Duke mbajtur parasysh afatet kohore të parashikuara nga këto dispozita dhe se qëllimi i seancës për vlerësimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit është që të dëgjohet subjekti i masave të sigurimit, për të vlerësuar nëse masa e caktuar ndaj tij është apo

jo e arsyeshme, në rastin konkret Gjykata çmon të analizojë nëse koha në dispozicion të kërkuarit dhe mbrojtësve të kërkuarit gjatë procesit të vlerësimit të masës ka qenë e mjaftueshme për realizimin e një mbrojtjeje efektive në këndvështrimin kushtetues.

63. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuarit me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është ekzekutuar ditën e nesërme në datën 21.10.2023 dhe, në zbatim të detyrimeve kushtetuese, vlerësimi i ligjshmërisë së saj është bërë nga gjykata brenda 48 orëve, në prani të kërkuarit dhe mbrojtësve të tij. Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore mbrojtësit e kërkuarit kanë kërkuar kohë për t'u njohur me materialet e çështjes, çka rezultoi të jetë pranuar nga gjykata, e cila ka vendosur shtyrjen me disa orë të seancës, ndërkohë që nuk është pranuar kërkesa e tyre për shtyrjen e seancës për ditën e nesërme. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes gjykata ka vendosur vazhdimin e masës.

64. Në ankim dhe rekurs kërkuari ka pretenduar cenimin nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë të së drejtës për mbrojtje efektive, si rrjedhojë e mosdhënies së kohës së nevojshme për studimin e dosjes. Në lidhje me të, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se koha e ofruar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për qëllime të realizimit të mbrojtjes dhe mundësitë e qasjes së kërkuarit me provat dhe aktet kishin qenë të mjaftueshme. Në të kundërt nga sa pretendohet, gjatë seancës për marrjen në pyetje të kërkuarit, nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë ishin respektuar garancitë e normave ndërkombëtare, aktit themeltar dhe dispozitat e procedurës penale, duke i njohur kërkuarit të drejtën e mbrojtjes profesionale dhe lirinë e zgjedhjes për t'u mbrojtur me mbrojtës të zgjedhur personalisht si të besuar të tij (*shih faqet 17-18 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Ky arsyetim i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar si i drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë (*shih faqen 80, paragrafi 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

65. Duke pasur parasysh sa më lart dhe në analizë të vendimmarrjeve të GJKKO-së së Apelit e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se, sipas procesverbalit të Prokurorisë së Posaçme të datës 21.10.2023 "Mbi ekzekutimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit nr. 112, datë 20.10.2023", kërkuarit i ka lindur drejta për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore që në momentin e njoftimit të vendimit të masës së arrestit, dhe që nga ky moment i kanë lindur të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara nga neni 34/b i KPP-së, për të cilat kërkuari ka marrë dijeni, çka provohet nga deklaratat e të drejtave të personit nën hetim, e nënshkruar prej tij. Po kështu, pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive janë marrë në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuara në lidhje me to. Në këtë këndvështrim, nisur nga fakti se kërkuari është mbrojtur nga mbrojtës të zgjedhur personalisht prej tij, Gjykata, ashtu siç ka pohuar në jurisprudencën e saj (*shih vendimet nr. 45, datë 03.10.2023; nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35,*

datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese), edhe në këtë rast thekson se mënyra se si mbrojtësit zgjedhin të realizojnë mbrojtjen mbetet çështje mes tyre e kërkuarit dhe i përket strategjisë së mbrojtjes, pra ushtrimit apo jo të të drejtave dhe garancive procedurale, bazuar në udhëzimet dhe marrëdhënien me të përfaqësuarin, çka në thelb përcakton sjelljen e avokatit. Në këtë kuptim ajo nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, për sa kohë që mbrojtja e ofruar nuk rezulton të ketë qenë joefektive nga pikëpamja kushtetuese, siç është edhe rasti i kërkuarit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e tij për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, për shkak të mospasjes së kohës së nevojshme për t'u njohur me provat gjatë gjyqimit të vlerësimit të masës, janë të pabazuara.

c) Për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

66. Gjykata eidenton se në kuadër të aspektit procedural të lirisë personale, në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, *cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas tij, vendimet e kundërshtuara përmbajnë të dhëna kontradiktore, referenca të gabuara, interpretim e zbatim të gabuar të ligjit, nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë e shteruese pretendimeve të tij dhe nuk kanë arsyetuar për shkaqet e mosmarrjes së tyre parasysh. Po sipas kërkuarit, gjuha e përdorur në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk është ajo shqipe.

67. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, i ka prapësuar si të pabazuara këto pretendime të kërkuarit, me argumentin se vendimet përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të parashikuara nga neni 245 i KPP-së dhe rezultojnë logjike, pa kundërthënie e përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

68. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit parashtrohen në drejtim të mjaftueshmërisë dhe qartësisë së vendimeve të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, për të vlerësuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara plotësojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata çmon të analizojë bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuarit bazuar në arsytimin që gjykatat kanë mbajtur për çështjen e tij.

69. Gjykata vë në dukje se neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 4, i KEDNJ-së kërkojnë vendimmarrje të gjyqtarit për vlerësimin e ligjshmërisë së masës, garancitë për të cilën përcaktohen në nenin 42 të Kushtetutës. Në lidhje me këto të fundit, në jurisprudencën e saj për shqyrtimin e masave të sigurimit Gjykata ka theksuar se vendimi i gjykatës duhet të plotësojë edhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket këtij standardi, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë.

Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Po sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

70. Në rastin e kërkuesit, Gjykata vëren se në përputhje me parashikimet e KPP-së, vendimet përmbajnë, ndër të tjera, parashtrimin e rrethanave të faktit dhe provat e administruara në gjykim, shkaqet që kanë shtyrë gjykatat për caktimin fillimisht të masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit dhe ndryshimin më pas të saj në “Arresti në shtëpi”, arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, përfundimet e nxjerra për rastin e kërkuesit, dispozitivin, si dhe dispozitat ligjore në të cilat gjykatat janë bazuar për vendimmarrjen. Vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese. Në lidhje me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se termat teknikë të përdorur në të, edhe pse vështirësojnë në pamje të parë kuptimin e vendimit, nuk shfaqin problematika qartësie për mbrojtësit ligjorë, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për t’i kuptuar ato. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

71. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për *cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe së drejtës për mbrojtje efektive, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nuk janë të bazuara.

B.1.2. Për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial të lidhur me parimin e proporcionalitetit

72. Gjykata çmon që pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial t’i analizojë duke u ndaluar tek analiza e pretendimeve që lidhen me mungesën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë së tij personale, si dhe parimin e proporcionalitetit. Për këtë qëllim, për të përcaktuar bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në analizën e dyshimeve të arsyeshme si

conditio sine qua non për kufizimin e lirisë personale, sipas parashikimeve të nenit 27, pika 2, shkronja “c”, si dhe parashikimet e nenit 17 të Kushtetutës.

a) Për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale

73. Kërkuesi ka pretenduar se caktimi i masave të sigurimit është bërë në kundërshtim me kushtin për ekzistencën e *dyshimeve të arsyeshme* për kufizimin e lirisë personale, pasi ndryshimet në legjislacion në kohën e qeverisjes së vjehrrit të tij nuk kanë pasur asnjë ndikim në privatizimin e terreneve sportive dhe Prokuroria e Posaçme nuk ka pretenduar në asnjë moment se aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara binin në kundërshtim me Kushtetutën ose ligje të tjera. Po sipas kërkuesit, të ardhurat e përfituara nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k. kanë qenë rrjedhojë e aktivitetit të ligjshëm tregtar, i cili i është nënshtruar edhe kontrollit të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila nuk ka konstatuar shkelje, ndërsa pretendimet se e bashkëshortja, subjekt i deklaramit të pasurisë, nuk ka deklaruar aktivitetin e shoqërisë janë të pabazuara, pasi ligji për parandalimin e konfliktit të interesit shtrihet tek personat e lidhur me zyrtarin dhe jo personat që kanë lidhje me personat e lidhur.

74. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për mungesën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale janë të pabazuara, pasi ai ka përfituar në mënyrë të paligjshme dhe ka shërbyer si hallkë në kalimin e këtij përfitimi, çka e bën atë bashkëpunëtor me shtetasin S.B., ndaj të cilit rëndon neni 260 i KP-së. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, kërkuesi është përpjekur të veshë përfitimin e paligjshëm me petkun ligjor të dividendit të përfituar nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k., e cila është krijuar vetëm për qëllime të dhënies së mitës. Masa “Arresti në burg” e caktuar ndaj tij është proporcionale, pasi ekziston mundësia që ai të largohet jashtë shtetit, të prishë provat ose të vërë në rrezik marrjen e tyre, si dhe të ndërhyjë te dëshmitarët. Prokuroria e Posaçme ka prapësuar, gjithashtu, se pretendimet e ngritura nga kërkuesi kanë marrë përgjigje në të tria shkallët e gjyqësorit ku gjykatat kanë analizuar konceptin e dyshimit të arsyeshëm. Ka qenë pikërisht kjo analizë që ka çuar në ndryshimin e masës së sigurimit nga gjykata e apelit. Fakti që Gjykata e Lartë ka pranuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit nuk e bën të paarsyetuar vendimin e saj.

75. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja “c”*).

76. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se “*dyshimet e arsyeshme*” për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet, bindje që krijohet në bazë të provave të marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

77. Po kështu, Gjykata ka theksuar se vlerësimi nëse ka pasur ose jo shkelje të lirisë personale merret bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se në këtë drejtim ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt e për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

78. Gjykata vëren se në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Një prej tyre është ai i caktimit të masës së sigurimit, që kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta (*neni 228*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve (*neni 229*). Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale (*neni 228, pika 1*).

79. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, për të vlerësuar nëse në rastin konkret përmbushet kushti për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale të kërkuesit, Gjykata do të analizojë nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

80. Gjykata vëren se kërkuesi është hetuar penalisht dhe u është nënshtruar masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues për shkak të ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme se në bashkëpunim me babanë e bashkëshortes së tij, shtetasin S.B., kanë kryer veprën penale të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë, përveçse kërkuesi edhe veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Sipas Prokurorisë së

Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se nga ana e babait të bashkëshortes së kërkuesit, në ushtrim të pushtetit të tij si Kryeministër, janë kryer veprime konkrete dhe aktive në drejtim të: përgatitjes dhe miratimit të projektligjeve dhe të projektvendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vetë politikë, me qëllim përshtatjen e tyre sipas nevojave që paraqiteshin për pesë familjet ish-pronare, ku përfitues i drejtpërdrejtë ishte dhe kërkuesi; kryerjes së kontrolleve administrative, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, me qëllim ushtrimin e presionit dhe dhënien e urdhrave konkrete për veprime që duhet të kryenin funksionarët që pengonin procesin e privatizimit të klubeve sportive në favor edhe të kërkuesit; vendosjes në dispozicion të kërkuesit të strukturave të ndryshme të administratës shtetërore për realizimin e procesit të kthimit të pronës, privatizimit të pronës shtetërore dhe ndryshimit të destinacionit të pronës edhe në favorin e kërkuesit. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, përfitimi i parregullt në favor të kërkuesit lidhet me dyshimin se të gjitha këto procedura, pavarësisht interesit publik në lidhje me nevojën për ambiente sportive, janë bërë me qëllimin e vetëm për të shtënë në dorë pronën dhe për ta përdorur atë për përfitime materiale, ku si të tilla janë konsideruar të gjitha ato përfitime monetare që kërkuesi ka marrë përmes shoqërisë ndërtuese, konkretisht nga shpërndarja e fitimeve të saj të akumuluar ndër vite, përpara se ai të deklarohej bashkortak i saj, të llogaritura në shumën 672 976 832 lekë ose 5 420 345 euro. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kërkuesi ka kryer veprime edhe për fshehjen e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, pasi është paraqitur si investitor në ndërtimin e bllokut të banesave, ndërkohë që nuk ka investuar asgjë, duke kryer veprime financiare, transaksione të copëzuara ose në *cash*, për të fshehur origjinën e përfitimit të parregullt monetar dhe paraqitur atë si të ardhur të ligjshme e të siguruar nga investimi në veprimtari ekonomike. Për të gjitha këto shkaqe, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit “Arresti në burg”.

81. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, masë të cilën e ka vlerësuar në vijim të ligjshme. Kërkuesi ka ankimuar vendimet për caktimin e vlerësimin e masës në GJKKO-në e Apelit, duke pretenduar, ndër të tjera, se organi i ndjekjes penale dhe gjykatat nuk kishin arritur të përcaktonin bashkëpunimin ose rolin e tij në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së dhe se të ardhurat e tij ishin të ligjshme, rrjedhojë e aktivitetit tregtar, ndaj nuk ekzistonin dyshime të arsyeshme për kufizimin e lirisë së tij personale.

82. Me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se veprimet e dyshuara të kërkuesit edhe pse jo me cilësi të posaçme, sikundër zyrtari apo funksionari i lartë, të kërkuara nga neni 260 i KP-së, do të inkriminohen sipas kësaj

dispozite, për sa kohë që dyshohet se ekziston mes tij dhe zyrtarit (shtetasit S.B.) një marrëveshje e veçantë “*pactum sceleris*”, sipas dispozitës së përgjithshme që parashikon bashkëpunimin, konkretisht nenit 25 të KP-së, pasi ishte pikërisht kjo lidhje/akord apo marrëveshje, e cila kishte aktivizuar realizimin e kësaj veprë. Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, i KP-së, gjykata ka vlerësuar se të ardhurat e përfituara nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k. nuk mund të shiheshin të shpëputura dhe episodike, por në lidhje logjike mes fakteve dhe provave, pra pa u ndarë nga origjina e shkeljeve të dyshuara në lidhje me procedurën e privatizimit të klubit të futbollit “Partizani” e ndryshimin e destinacionit të territoreve ku janë bërë ndërtime, apo veprimeve që kishte kryer së bashku me të hetuarit e tjerë në krijimin e shoqërisë, momentit të publikimit të ortakërisë së tyre, transaksioneve të copëzuara të kryera, të cilat mbajnë në jetë dyshimin e ekzistencës së faktit penal, qoftë të korrupsionit pasiv, ashtu edhe atë të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Ndaj, në rastin e kërkuarit plotësohej kushti i domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit personal, ai i dyshimit të bazuar në prova i përcaktuar në nenin 228, pika 1, të KPP-së (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqet 174-183*).

83. Në kontroll të ligjshmërisë së vendimmarrjes së GJKKO-së së Apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se Prokuroria e Posaçme kishte argumentuar dhe evidentuar se veprimet e kryera nga babai i bashkëshortes për marrjen në administrim të pronës nga kërkuari, nënshkrimin e kontratës me ish-pronarët, shkarkimin nga detyra të një gjenerali, kryerjen me shpejtësi të veprimeve nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kthimin e pasurisë, ndryshimin e destinacionit të saj, si dhe përfitimet monetare të kërkuarit nga ndërtime të kryera, mbanin në jetë dyshimin se ai kishte përfituar në mënyrë të parregullt nga këto veprime. Po sipas këtij kolegji, në analizë të nenit 228 të KPP-së, gjykatat e ulëta kishin argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauresive për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale dhe arsyetimet e tyre ishin mbështetur në vlerësimin cilësor të të gjitha provave (*shih faqet 76-78, paragrafët 31-38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

84. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Gjykata vëren se, në kuadër të zbatimit të neneve 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe 228, pika 1, të KPP-së, në vlerësimin e tyre për masën e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” të vendosur ndaj kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë treguar kujdes në analizën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova për ekzistencën e një *pactum sceleris* mes tij dhe babait të bashkëshortes, ish-Kryeministër i vendit, duke arsyetuar në vendimmarrjet e tyre për faktet, informacionet, si dhe provat e marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat kanë krijuar bindjen se mes kërkuarit dhe veprave penale për të cilat dyshohet ekziston një lidhje objektive,

që përligj ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në prova, si kusht *sine qua non* për kufizimin e lirisë personale. Gjykatat kanë arritur në konkluzionin se në unitetin e tyre këto dyshime ishin të tilla që arrinin të bindnin edhe një vëzhgues të jashtëm se vepra penale kishte ndodhur dhe se ajo mund të ishte kryer nga kërkuesi. Në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimi i gjykatave të zakonshme në funksion të ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

85. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për mungesën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

b) Për cenimin e parimit të proporcionalitetit

86. Kërkuesi ka pretenduar se, duke pasur parasysh personalitetin, ndjenjën e tij morale, strehimin, profesionin, burimet financiare, lidhjet familjare, faktin se nuk kishte qenë ndonjëherë i dënuar, ishte familjar dhe profesor i nderuar, si dhe faktin se nuk ekzistonte rreziku që ai të largohet, të pengonte mbarëvajtjen e drejtësisë ose të kryente krime të tjera, gjykatat duhet të kishin marrë në konsideratë vendosjen e masave alternative, siç është “*Garancia pasurore*”, për të cilën ka ofruar edhe dakordësinë.

87. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimet e ngritura nga kërkuesi kanë marrë përgjigje në të tria shkallët e gjyqësorit, ku gjykatat kanë analizuar konceptet e përshtatshmërisë e proporcionalitetit në caktimin e masave. Masa “*Garancia pasurore*” është e papërshtatshme, pasi kërkuesi dyshohet se ka përfituar mitë në shuma të mëdha.

88. Gjykata vëren se, krahas kushtit të ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, neni 228 i KPP-së ka përcaktuar edhe disa kushte të tjera. Konkretisht, sipas pikës 3 të këtij neni, masat e sigurimit personal vendosen kur: *i*) ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; *ii*) i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; *iii*) për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (*pika 3*). Për sa u përket kritereve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 229 të KPP-së, në caktimin e tyre gjykata mban parasysh *përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit* që duhen marrë në rastin konkret (*pika 1*) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast,

mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2).

89. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas nenit 237 të KPP-së një ndër masat shtrënguese ndaj lirisë personale është edhe ajo “Arresti në shtëpi”, përmes së cilës gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon.

90. Në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese e ligjore, Gjykata, në vijim, do të analizojë masën “Arresti në shtëpi” të caktuar ndaj kërkuesit nga GJKKO-ja e Apelit, të lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, përkundrejt parashikimeve të nenit 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të vendoset vetëm me ligj, për një interes publik dhe duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka shkaktuar atë, si dhe sipas kushteve e kritereve të përcaktuara në nenet 228 e 229 të KPP-së. Ndaj, për të vlerësuar nëse në rastin konkret janë respektuar kriteret kushtetuese për kufizimin e lirisë personale, Gjykata do të verifikojë nëse këto gjykata kanë arsyetuar dhe interpretuar në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” të caktuar ndaj kërkuesit, si dhe nëse kanë mbajtur në konsideratë se ajo përmbush qëllimin për të cilin është caktuar.

91. Për këtë, Gjykata do të analizojë nëse GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë arsyetuar në lidhje me ekzistencën e *shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, të rrezikut që kërkuesi të largohet, si dhe të rrezikut që ai të kryejë krime të tjera*, për shkak të *rrethanave të faktit dhe personalitetit të tij*. Gjithashtu, për të arritur në përfundimin se kjo masë plotëson kriterin e proporcionalitetit, Gjykata do të shqyrtojë nëse gjykatat kanë arsyetuar për vendosjen e masës së sigurimit, duke mbajtur në konsideratë *kontekstin e përgjithshëm të fakteve të çështjes*, përfshirë këtu personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve dhe *mënyrën në të cilën është kryer hetimi*, si dhe se *nëse ajo është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur*, pra që çdo masë tjetër është e papërshtatshme në raport me nevojat e sigurimit.

92. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bërë me ligj, bazuar në parashikimet e nenit 27, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 228, pika 1, të KPP-së, në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj tij, në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287 të KP-së. Po kështu, duke pasur parasysh jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës rregullat procedurale penale që lejojnë kufizimin e lirisë personale i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, të lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj interesi publik është i prezumuar (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata çmon se ndërhyrja në të drejtat kushtetuese të kërkuesit i përgjigjet një interesi publik.

93. Për sa i përket kriterit të *proporcionalitetit*, Gjykata do të analizojë në vijim aspektet e *nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë* së masës në raport me parashikimet e neneve 228 e vijues të KPP-së. Në gjykimin kushtetues lidhur me nevojën e ndërhyrjes mbi të drejtat kushtetuese të kërkuesit, Gjykata analizon fillimisht nëse masat konkrete të sigurimit të vendosura ndaj kërkuesit janë të nevojshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm të mbarëvajtjes së procedimit penal në kuadër të të cilit ato janë vendosur. Më tej, Gjykata vlerëson nëse masat e vendosura janë të përshtatshme për të realizuar këtë qëllim. Së fundi, Gjykata vlerëson nëse qëllimi i ligjshëm i mbarëvajtjes së procedimit penal mund të arrihej me vendosjen e masave më pak të ashpra. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

94. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar të drejtë konkluzionin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për ekzistencën e kushtit të përcaktuar në nenin 228, pika 3, shkronja “b”, të KPP-së, konkretisht rrezikut që kërkuesi të largohet, ndërkohë që, në kundërshtim me atë gjykatë, ka vlerësuar se nuk përmbushej kushti i përcaktuar në shkronjën “c” të këtij neni, për shkak se nuk ekzistonin prova që mbështesnin dyshimin se ai mund të kryente krime të rënda ose të njëjta me ato për të cilat po procedohej, pasi nuk ishte i dënuar më parë, si dhe se likuidimi i shoqërisë “Homeplan” sh.p.k. nuk mund të konsiderohej si kusht për kufizimin e lirisë personale, në kuptim të nenit 228, pika 3, shkronja “c”, të KPP-së. Ndërsa në lidhje me kërkesën e kërkuesit për caktimin e masës “Garancia pasurore”, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se caktimi i masës së sigurimit ose zëvendësimi i saj nuk mund të vlerësoheshin të shprehura nga kriteri i përshtatshmërisë, proporcionalitetit dhe nevojshmërisë, ndaj, duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale për të cilat ai dyshohej, kjo kërkesë nuk mund të pranohej. Në këto kushte, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur ndryshimin e masës “Arresti në burg” të caktuar ndaj kërkuesit në “Arresti në shtëpi”, si dhe detyrimin e tij për të mos u larguar nga banesa e për të mos komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë me të (*shih faqet 180-183 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

95. Vendimi i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar i drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë në drejtim të parimit të proporcionalitetit. Sipas Gjykatës së Lartë, GJKKO-ja e Apelit kishte arsyetuar në mënyrë ezauroese për ekzistencën e rrezikut që kërkuesi të largohet, si dhe për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, për shkak të mungesës së rrezikut të kryerjes prej tij të krimeve të rënda ose të të njëjtit lloj me ato për të cilat po procedohej. Po kështu, Gjykata e Lartë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për modalitetet e

zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, me argumentin se paragrafi i dytë i nenit 237 të KPP-së linte në diskrecionin e gjykatës përcaktimin e modaliteteve të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së monitorimit të masës së caktuar (*shih faqet 76-78, paragrafët 31-38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

96. Në analizë të vendimeve të mësipërme gjyqësore për qëllime të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe qëndrimet e saj u ndanë në dy drejtime.

97. Sipas njërit qëndrim¹, masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” e vendosur ndaj kërkuesit është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit e rëndësinë e faktit penal për të cilin ai dyshohet dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale, ndërsa mban në konsideratë edhe treguesit personalë të kërkuesit. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal të arrestit në shtëpi në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së. Konkretisht, gjykata e apelit ka arsyetuar për “parimin e proporcionalitetit, duke theksuar rëndësinë e ekuilibrit të interesave proceduralë me ato personalë, me qëllimin që ndaj kërkuesit të vendoset një masë shtrënguese e përshtatshme, objektive, e patepruar dhe e tolerueshme”. Ajo është shprehur në vendimin e saj se është “udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë dhe i gradualitetit për të përzgjedhur masën e sigurimit personal që përmbush nevojat e procedimit penal dhe që rezulton më oportune në raport me rastin konkret dhe provat e paraqitura”. Po sipas gjykatës së apelit, masa e arrestit në shtëpi garanton praninë në procedim të kërkuesit; ajo respekton parimin e proporcionalitetit, përshtatshmërisë dhe gradualitetit, sepse njihet nga ligjvënësi si alternativë e paraburgimit për fuqinë shtrënguese maksimale që ofron, e cila, po ashtu, është në raport të drejtë me rëndësinë e fakteve penale dhe sanksionet e parashikuara për veprat penale konkrete, për të cilat ai dyshohet. Arsyetimi i gjykatës së apelit nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se shkaqet në rekurs që lidheshin me proporcionalitetin e masës së sigurimit haptazi kanë karakter të mirëfilltë faktual vlerësues, që është atribut ekskluziv i gjykatave të faktit. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit se masa e caktuar ndaj tij nuk është proporcionale është i pabazuar.

¹ Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Ilir Toska votuan për rrëzimin e këtij pretendimi.

98. Sipas qëndrimit tjetër,² gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë në masën dhe nivelin që kërkon ndërhyrja në të drejtat dhe liritë kushtetuese, në mënyrë që ajo të konsiderohet proporcionale dhe në lidhje me këtë, të arsyetonin edhe pse ishte e përshtatshme. Po ashtu nuk kanë analizuar nëse një masë tjetër me natyrë personale apo edhe një qëndrim i ndryshëm në lidhje me kërkesën e prokurorisë nuk do të ishte në gjendje të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal apo do ta vinte në rrezik atë. Arsyetimi i GJKKO-së së Apelit për caktimin e masës të sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, i bazuar në dyshimet për kryerjen e veprës penale dhe rrezikun e ikjes së kërkuarit, është i pamjaftueshëm në aspektin kushtetues për të justifikuar nevojën e kësaj ndërhyrjeje. Vetëm fakti që masa e sigurimit është një masë me natyrë të ndërmjetme, që jepet gjatë një procedimi penal që është duke u kryer, nuk nënkupton se justifikon edhe mungesën e analizës së gjykatës në lidhje me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që justifikojnë masën kufizuese të lirisë. Në këtë drejtim, në vendimet e gjykatave nuk është arsyetuar mbi ato shkaqe dhe elemente të procedimit penal që kanë çuar në ekzistencën e dyshimit të ikjes/largimit të kërkuarit, me qëllim shmangien nga procesi penal, e lidhur kjo edhe me personalitetin, profesionin dhe aspekte të tjera të figurës dhe jetës private e profesionale të tij. Nga ana tjetër, gjykatat nuk kanë arsyetuar nevojën e ndërhyrjes as në drejtim të rrezikut për të penguar mbarëvajtjen e procedimit penal, duke pasur parasysh fazën në të cilën ndodhet ky procedim, pra për të garantuar mosrrezikimin e marrjes apo vërtetësisë së provave të këtij procedimi (apo helmimin e provave). Për këtë arsye, kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në drejtim të elementit të nevojës të lidhur me përshtatshmërinë e kësaj mase mbështetur në detyrimet që vendos neni 17 i Kushtetutës.

99. Për sa më lart, për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të proporcionalitetit, si pjesë e aspektit substancial të lirisë personale, Gjykata vëren se, në kushtet kur nuk u formua shumica prej pesë gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ky pretendim konsiderohet i rrëzuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për jetë private

100. Në ankimin kushtetues individual kërkuar ka pretenduar edhe për jetë private, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e kufizimit të jetës së tij shoqërore, për shkak të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” të caktuar nga GJKKO-ja e Apelit. Po sipas tij, vendimi i kësaj gjykate i ka cenuar edhe lirinë e korrespondencës e të komunikimit, pasi është ndaluar të mbajë kontakte me mediat për të shprehur lirisht opinionet e tij. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur prapësime në këtë drejtim.

² Gjyqtarët Holta Zaçaj, Genti Ibrahimimi dhe Marjana Semini votuan për pranimin e këtij pretendimi.

101. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se e drejta për jetë private nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihen neni 35 (*mbrojtja e të dhënave personale*), neni 36 (*liria dhe fshehtësia e korrespondencës dhe e komunikimit*) dhe neni 37 (*paprekshmëria e banesës*). Sipas Gjykatës, e drejta për jetë private nuk ka karakter shterues, por, në thelb, duhet t'i sigurojë individit një hapësirë brenda së cilës ai mund të zhvillojë dhe plotësojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij, ku përfshihet edhe zhvillimi ose ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

102. Po sipas Gjykatës, liria e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, e sanksionuar në nenin 36 të Kushtetutës, përbën një nga të drejtat themelore autonome dhe që mund të mbrohet veçmas gjyqësisht. Ajo e ka vlerësuar atë nën konceptin e mbrojtjes së drejtës së jetës private, duke theksuar se jeta private përbën hapësirën e mbrojtur, brenda së cilës individi zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë (*shih vendimin nr. 30, datë 05.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

103. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

104. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata do të analizojë nëse kërkuesi, i izoluar nën masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", ka pasur mundësinë të krijojë hapësirën e nevojshme për të zhvilluar personalitetin e tij, si dhe për të ushtruar lirisht lirinë e korrespondencës dhe të komunikimit.

105. Në drejtim të *cenimit të jetës private*, Gjykata vëren se në rekurs kërkuesi ka pretenduar *cenimin* e neneve 8 dhe 10 të KEDNJ-së, për shkak se kufizimi i vendosur nga GJKKO-ja e Apelit për të mos komunikuar me persona të tjerë, përveç atyre që bashkëjetojnë me të, është bazuar në përmbajtjen e mëparshme të nenit 237 të KPP-së, e cila është shfuqizuar me ndryshimet e bëra këtij kodi në vitin 2017. Po sipas tij, modalitetet e mbikëqyrjes së kësaj mase kanë të bëjnë me kontrollin periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit në banesën private, i cili nuk mund të kryhet pa një vendim gjyqësor.

106. Gjykata e Lartë e ka çmuar të pabazuar këtë pretendim të kërkuesit, duke vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, detyrimi i kërkuesit për të mos komunikuar me

persona të tjerë të ndryshëm nga bashkëbanuesit e tij tolerohet edhe nga përmbajtja aktuale e nenit 237 të KPP-së, i cili, në paragrafin e dytë të tij, parashikon diskrecionin e gjykatës, gjyqtarit për hetimet paraprake, për të përcaktuar edhe modalitetet e ekzekutimit e të mbikëqyrjes (monitorimit) të masës së caktuar (*shih paragrafin 38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

107. Gjykata evidenton se neni 237, pika 2, i KPP-së para ndryshimeve të kësaj dispozite në vitin 2017 parashikonte se, kur ishte e nevojshme, gjykata i vendoste kufizime ose ndalime të pandehurit për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetonin me të, ndërsa me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017 ajo parashikon tashmë se në rastet kur cakton masën “Arresti në shtëpi”, gjykata cakton edhe mënyrën e ekzekutimit e të mbikëqyrjes së saj, duke lënë në këtë mënyrë në diskrecionin e gjykatës përcaktimin ose jo të kufizimeve të tjera.

108. Në analizë të relacionit të projektligjit nr. 35/2017, Gjykata konstaton se qëllimi i ligjvënësit në ndryshimin e përmbajtjes së dispozitës në fjalë ka qenë që, në rastet e caktimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” t’i lërë hapësirë gjykatës të përcaktojë edhe mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj, në mënyrë që ajo të aplikojë eventualisht edhe legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike nëpërmjet forcave të rendit, nëse e konsideron të nevojshme.

109. Po kështu, Gjykata e çmon të pabazuar edhe pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private, si rrjedhojë e zbatimit të modaliteteve, sipas nenit 237 të KPP-së, që lejojnë kontrollin periodik të banesës nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pasi kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë cenimin e kësaj të drejte në rastin konkret. Nga ana tjetër, për sa i përket lirisë së korrespondencës dhe komunikimit, Gjykata evidenton se parashikimet e ligjit nr. 81/2020 ofrojnë garanci të mjaftueshme për ushtrimin nga kërkuesi të kësaj lirie, ndaj çmon se pretendimet për cenimin e saj janë pabazuara, pasi ai nuk ka arritur të përcaktojë veprimet konkrete të autoriteteve shtetërore që i kanë kufizuar këtë liri.

110. Për sa i përket vlerësimit të cenimit të jetë private, për shkak të ndalimit të kërkuesit për të komunikuar me persona të tjerë, Gjykata, pasi mori në shqyrtim këtë pretendim të tij, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe u grupua në dy qëndrimet, si më poshtë.

111. Sipas njërës qëndrim³, nuk ka cenim të së drejtës për jetë private dhe vendosja e kufizimit ose ndalimit të të pandehurit për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë me të, përbën vetëm një mënyrë për ekzekutimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe nuk është në vetvete një masë e mëvetësishme sigurimi. Ashtu siç ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, ndalimi i caktuar ndaj kërkuesit lejohet nga përmbajtja aktuale e nenit 237, pika 2, të KPP-së, i cili parashikon diskrecionin e gjykatës për të përcaktuar, krahas masës së arrestit në shtëpi, edhe modalitetet e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj (*shih paragrafin 38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për më tepër, ndryshimi i nenit 237 të KPP-së me ligjin nr. 35/2017 nuk mund të konsiderohet zbehje apo zbutje e masës së sigurimit të arrestit në shtëpi, por siç rezulton edhe nga materialet përgatitore të miratimit të ndryshimeve ligjore, ka synuar t’u përgjigjet zhvillimeve të reja shoqërore, duke i dhënë mundësi gjykatës, sipas diskrecionit të bazuar në ligj dhe rrethanave konkrete të çështjes, të caktojë mënyrën më të përshtatshme të ekzekutimit të masës. Për rrjedhojë, ndalimi i kërkuesit për të komunikuar me persona të tjerë nuk përbën kufizim tjetër shtesë, përveç atij që ka vendosur vetë masa “Arresti në shtëpi”, ndaj pretendimi i tij për cenimin e jetës private është i pabazuar.

112. Sipas qëndrimit tjetër,⁴ vendosja nga gjykata e ndalimit për kërkuesin për të mos komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë në të njëjtën banesë me të, përbën një kufizim të ri, shtesë, të të drejtave të tij kushtetuese, konkretisht asaj për jetë private, ndërkohë që kjo nuk konsiderohet si një masë që synon ekzekutimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Neni 237, pika 2, i KPP-së në përmbajtjen e tij përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 parashikonte kompetencën e gjykatës për të vendosur edhe kufizime të tjera shtesë, kur kjo ishte e nevojshme. Me ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite, ligjvënësi nuk i ka njohur gjykatës të drejtën dhe kompetencën që të caktojë apo vendosë kufizime të tjera përtej asaj të lirisë personale, por vetëm për të caktuar mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së masës së sigurimit, çka do të thotë që gjykata ka diskrecion që të caktojë dhe urdhërojë vetëm ato veprime që bëjnë të mundur dhe ndikojnë drejtpërdrejt në ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e saj nga organet përgjegjëse. Sipas pikës 1 të nenit 237 të KPP-së me vendimin e arrestit në shtëpi gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. Në kuptim të kësaj dispozite, diskrecioni i gjykatës lidhet vetëm me ato veprime që i shërbejnë qëllimit për caktimin e kësaj mase konkrete. Për rrjedhojë, në rastin konkret mungon lidhja mes masës me natyrë shtrënguese të caktuar ndaj kërkuesit dhe mënyrës se si ndihmon ndalimi për të komunikuar me persona të tjerë në ekzekutimin apo mbikëqyrjen e saj. Nëse përpara gjykatës

³ Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Ilir Toska votuan për rrëzimin e këtij pretendimi

⁴ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Genti Ibrahimimi dhe Marjana Semini votuan për pranimin e këtij pretendimi.

parashtrohet nevoja e përcaktimit të veprimeve me natyrë dytësore dhe ndihmëse, ato do të duhet të argumentohen në çdo rast në drejtim të sigurimit, që të plotësojnë qëllimin për të cilin është caktuar vetëm masa kufizuese e lirisë. Në këtë drejtim, interpretimi që i është bërë nga gjykatat nenit 237, pika 2, të KPP-së është arbitrare dhe joproporcional, pasi ka shtrirë dhe zgjeruar kufijtë e vlerësimit të gjykatës së zakonshme gjatë shqyrtimit prej saj të ekzistencës së kritereve dhe kushteve për caktimin e një mase sigurimi personale me natyrë shtrënguese, duke dalë kështu tej qëllimit të ligjvënësit dhe frymës së normës së re procedurale dhe duke caktuar për kërkuesin një masë të re me natyrë kufizuese. Nga ana tjetër, ndërsa interpretimi i gjykatave të zakonshme duhet të synojë zgjerimin e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese individuale të individëve, në rastin konkret ka përbërë në fakt një kufizim të hapësirës së mbrojtjes kushtetuese. Ndalimi i caktuar për kërkuesin nga gjykatat për të mos komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë në të njëjtën banesë me të, përbën në fakt një masë të re shtesë, që edhe pse është caktuar me vendim të gjykatës, jo vetëm që nuk gjen mbështetje ligjore, por përbën një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në të drejtën e tij për jetë private.

113. Për sa më lart, për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për jetë private, Gjykata vëren se, në kushtet kur nuk u formua shumica prej pesë gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ky pretendim konsiderohet i rrëzuar.

114. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit duhet të rrëzohet, me argumentet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 05.12.2024

Shpallur më 15.01.2025

[shqiptarja.com]